



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "TSR shpk" të datës 29.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "174 Prodhimi, furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave për njësitë e banimit në Komunën e Prishtinës - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-5086-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "TSR shpk" të datës 29.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "174 Prodhimi, furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave për njësitë e banimit në Komunën e Prishtinës - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-5086-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "TSR shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 29.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "174 Prodhimi, furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave për njësitë e banimit në Komunën e Prishtinës - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-5086-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritu*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1.- "Arsyet e prezantuar në letrën standarde për eliminimin tonë janë arsye të pasakta dhe të pabazuara në ligj. Arsyeja eliminuese kinse në poz. 3, 4 dhe 5 nuk janë dorëzuar sipas kërkesave të DT dhe ST nuk është e saktë pasi që të gjitha mostrat e dorëzuara janë në përputhje të plotë me dosjen e tenderit. Sa i përket trashësisë së tabelës prej 2 cm por edhe dimensioneve tjera për të cilat ne jemi eliminuar, vlen të thuhet që edhe tenderuesi që AK e ka shpallur fitues i ka dorëzuar po ashtu mostrat me dimensionet e njëjta dhe me trashësi të tabelës prej 2 cm. Pra nuk është as e ligjshme dhe as e logjikshme që ne të eliminohemi për këtë arsye ndërsa të shpallet fitues një OE që ka dorëzuar po ashtu tabelat me trashësi 2 cm. Vlen të shtohet që aktualisht ne jemi duke e realizuar kontratën e njëjtë me Komunën e Prishtinës. Pra punën për të cilën është shpallur ky aktivitet i prokurimit, jemi duke e realizuar aktualisht dhe AK asnjëherë nuk ka pasur asnjë vërejtje. Sidoqoftë, ne edhe për këtë aktivitet të prokurimit i kemi dorëzuar mostrat saktësisht sikurse janë kërkuar me DT dhe ST prandaj nuk qëndron arsyeja eliminuese e prezantuar nga AK".

P.2.- "Tenderuesi i rekomanduar është i papërgjegjshëm dhe nuk ka përmbushur kërkesat e DT.

2.1. OE i shpallur fitues për poz 3+4 prezenton një autorizim nga firma RSM e Shqipërisë. Mirëpo askund nuk ceket se kjo firmë prodhon produkte sipas kërkesës nr. 3 dhe 4 të paramasës dhe parallogarisë njëkohësisht në katalogun e prezentuar askund nuk vrehet asnjë produkt i ngjashëm e më pak produkt që kërkohet sipas poz. 3 dhe 4 sipas kërkesës së AK. Shiko deshmit e prezentuara nga OE (6.1 dhe 6.2).

2.2. Po ashtu OE fitues ka prezantuar edhe një autorizim nga një firm kineze për poz. 7. Mirëpo mungon katalogu i kërkuar nga AK. Për befasinë tonë, AK ndahet i knaqur me disa shkresa nga interneti dhe nuk prezentohet fare katalogu. Shiko dëshminë (katalog mailbox.pdf) te dëshmia e prezentuar nga OE.

2.3. Te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 kapaciteti teknik dhe profesional. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkohet: 6. Të dorëzohen Certifikata 3M apo e ngjajshme për pozicionet 3 dhe 4 6. Operatori ekonomik te prezantoj certifikatat valide Këtu OE prezenton (8. Certifikata 3M per pozicionet 3 dhe 4.rar) certifikaten kinse nga Orafol, në emër të RSM mirëpo në realitet ky OE nuk e posedon fare certifikaten as të ORAFOL dhe as të 3M. Ky posedon vetem një fletë teknike të lëshuar dhe të ngarkuar në internet si nga ORAFOLLI si nga 3M dhe në të cilat dukomente kanë qasje të gjithë të interesuarit dhe këto janë vetëm fleta teknike e jo certifikata (pasiqe per tu certifikuar per certifikta 3m apo orafoll duhet të bëhet kontrolla pranë kompanisë e cila certifikohet Ne ket rast është dashur që të behet Kontrolla nga Orafolli apo nga 3M dhe të lëshohet certifikata valide, e jo në fletë teknike (siç është cekur ne cdo fletë kinse ne certifikaten e orafollit ne anen e djathtë TECHNICAL DATASHEED) është shumë qudi se si AK nuk e ka kuptuar dallimin në mes të certifikatës dhe fletës teknike. Si përfundim OE fitues fare se posedon as certifikaten e 3M dhe as të Orafollit por posedon vetëm disa flata teknike si te 3M njëkohësisht edhe te Orafollit e sa për informacion të AK Orafolli nuk certifikon dhe nuk lëshon fare certifikata për OE.

2.4. Në DT është përcaktuar kërkesa nr.5 lidhur me kapacitetin profesional/teknik si vijon: 5. Mostrat duhet të dorëzohen në ditën para hapjes së ofertave në formë fizike për pozicionet -3, 4 dhe 7. 5. Mostrat te derzohen per pozicionet 3, 4 dhe 7 Këtu ky OE sa i perket kërkesës për Poz nr. 3 e cila ka qenë në qoftë se shikojmë te përshkrimi i paramasës ka qenë shumë kuart e cekur (citojmë): POZ 4 citojmë: Furnizimi i tabelave, transporti dhe montimi i emërtimit të rrugëve, shkrimi i

emrave në një anë, në tabela dhe vendosja e tabelave në shtylla (sipas specifikave teknike) Materiali i tabelës për emërtimin e ZQP-ve (Zona e Qarkullimit Publik – rruga, sheshi,...) është fletë "3M scotchlite", prej materiali ngjites parareflektiv dhe me intensitet të lartë. Të gjitha tabelat e emërtimeve do të vihen jashtë në natyrë ose në ndërtesë kështu që ato duhet të jenë të qëndrueshme ndaj motit me garanci jo më pak se 10 vjet. Tabela për emërtime të ZQP-ve ka formë drejtkëndore dhe përmasat e saj janë: Gjatësia e nevojshme 60 cm – 100 cm X gjerësia 25 cm. Minimumi i gjatësisë së tabelës është 60 cm dhe maksimumi i saj mund të arrijë deri në 100 cm (Fig.1) Emri i rrugës që ka 10 shkronja përdoret tabela 60 cm, Emri i rrugës që ka 11 deri 20 shkronja, tabela ka gjatësi 80 cm, Emri i rrugës që ka mbi 20 shkronja, tabela ka gjatësi 100 cm. Figura.1 Pra sic mund të lexohet për këtë Poz. është kërkuar të sillet tab. sipas Figura.1 e cila duket kështu si në specifikacionin teknik. Dhe shumë kjo të shkruhet Citojm: shkrimi i emrave në një anë, në tabela dhe vendosja e tabelave në shtylla (sipas specifikave teknike) Vet AK thotë se këto duhet të jenë trashësi 1 cm pastaj duhet të kapen dhe vendosen në shtyllë ndërsa për këtë Poz. OE i shpallur fitues sjell një tabelë e cila fare nuk përputhet me kërkesën e AK sipas figurës nr 1 dhe është vetëm për mur nuk ka mundësi kapjeje në shtyllë. Njëkohësisht trashësia e saj është vetëm 0.6 cm apo 6mm dhe nuk përputhet fare me kërkesën e AK (Shiko dëshmitë foto nr. 2 pastaj 2.1 dhe 2.2".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Ju njoftojmë se oferta juaj është refuzuar, pasi është vlerësuar si e papërgjegjshme për arsyet në vijim:

Gjatë vlerësimit të mostrave për pozicionet 3, 4 dhe 7, janë konstatuar mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, si më poshtë:

Pozicioni 3: Sipas FDT-së, Gjatësia dhe gjerësia e tabelës janë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, respektivisht me dimensionet e kërkuara prej 60 - 100 cm në gjatësi. Megjithatë, materiali i përdorur për emërtimin e rrugëve është i tipit ngjites, që nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Gjithashtu, trashësia e tabelës së ofruar është 2 cm, ndërkohë që në dosjen e tenderit është kërkuar që ajo të jetë 1 cm.

Pozicioni 4: Sipas FDT-së, Gjatësia dhe gjerësia e tabelës janë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, respektivisht me dimensionet e kërkuara prej 60 - 100 cm në gjatësi. Megjithatë, materiali i përdorur për emërtimin e rrugëve është i tipit ngjites, që nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Gjithashtu, trashësia e tabelës së ofruar është 2 cm, ndërkohë që në dosjen e tenderit është kërkuar që ajo të jetë 1 cm.

Pozicioni 7: Sipas kërkesës të dosjës së tenderit, dimensionet e produktit për pozicionin 7 duhet të jenë 370 mm (gjerësi) x 370 mm (gjatësi) x 110 mm (lartësi).

Në mostrën e dorëzuar nga operatori ekonomik, janë vërejtur këto devijime:

Gjerësia: 370 mm (në rregull)

Gjatësia: 360 mm (më e vogël se sa kërkesa prej 370 mm)

Lartësia: 108 mm (më e vogël se sa kërkesa prej 110 mm).

Bazuar më sipër, mostra për pozicionin 7 nuk përmbush plotësisht kërkesat teknike të dosjes së tenderit, për shkak të devijimeve në gjatësi dhe lartësi.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuar në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi parimisht nuk i konteston arsyet për të cilat është eliminuar oferta e tij si e papërgjegjshme. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT duke përfshirë edhe deklaratën për GOE, qarkullimin financiar, listën e kontratave, autorizimet dhe katalogjet. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.